




REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës
01 Nr. _____/2019
Datë: 31.01.2019

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2019, pas diskutimit lidhur me pikën e 7 të rendit të ditës: Shqyrtimi Propozim Vendimit për ngritjen e lapidarit për Martirët e Familjes, e miratoi këtë:

V E N D I M
për ngritjen e lapidarit për Martirët e Familjes Vejsa

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës aprovon propozimin për ngritjen e lapidarit për Martirët e Familjes Vejsa, në pjesët e ngastrave kadastrale P-70705028-04403-1 Z.K. Gjakovë jashtë qytet, rrugë publike, dhe në pjesën e ngastrës kadastrale P-70705028-04381-11 Z.K Gjakovë jashtë qytet, në pronësi të Komunës së Gjakovës.
2. Lapidari përkujtimorë do të ngritet në shenjë nderimi dhe respekti për martirët e familjes Vejsa të rënë - ekzekutuar në këtë vend me datë 01.04.1999 .
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës së Gjakovës.
4. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës, z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal,
 - Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit .
 - Drejtorisë për Shërbime Publike ,
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit



Kryetari i Kuvendit të Komunës

L. Anton Shala